Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 531/13
Datë 24.05.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 24.05.2013 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e "The Cambridge School", Prishtinë, për periudhën: 24.05.2013 - 24.05.2014 për të ofruar kurse të gjuhës angleze:

1.1 Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të hartojë një përshkrim të punës për Drejtorin e Studimeve, i cili do të jetë përgjegjës për menaxhim akademik. Pos vëzhgimit sistematik dhe të rregullt të mësimdhënësve, atyre duhet ofruar edhe informata kthyese dhe udhëzime, në lidhje me pikat 2 dhe 3.
- Të siguroj dëshmi të politikes mbi zhvillimin profesional të shkathtësive të mësimdhënies i cili mbështetet në udhërrëfyesin e AKK-se si dhe të sistemeve efektive për implementimin e kësaj politike.
- Të harmonizojë mësimdhënien, testimin dhe certifikimin me Kornizën e Përbashkët Evropiane.

- Të bëjë analizë sistematike të informatave kthyese të nxënësve, dhe të evidentojë veprimet e ndërmarra. Informatat kthyese duhet të merren edhe nga mësimdhënësit në lidhje me sistemet dhe proceset.
- Të krijojë politika dhe procedura aty ku ato nuk ekzistojnë (p.sh. për vlerësim të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për transfer të kredive)

1.2. Afati i plotësimit i të gjitha kushteve është deri me 30.08.2013.

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë: 24.05.2013, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

2.2. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

4. Vendimi u dërgohet:

- "The Cambridge School", Prishtinë;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi